



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



## Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 695/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

### V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.589/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji Biznesi për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së.
- II. Hiqet masa e pezullimit te akreditimit për programin e studimit të Kolegjit Biznesi kampusi në Prishtinë:
  - Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS; dhe
  - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS.
- III. Hiqet masa e pezullimit te akreditimit për programin e studimit të BPrAL Kolegji Biznesi dega në Vushtrri:
  - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS.
- IV. Lejohet regjistrimi i studenteve ne programet e cekura ne piken dy dhe tre të këtij vendimi.
- V. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.580/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji Biznesi me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr. 580/17, datë 06.07.2017, me te cilin vendim Kolegjit Biznesi i është pezulluar akreditimi për programe të studimit: për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018 në kampusin në Prishtinë:

Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS; Menaxhment dhe Financa, MA, 120 ECT; Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS; Menaxhimi i Emergjencave, MA, 120 ECTS; Banka dhe Financa në Biznes, BA; Juridik – Penal, LLM, 60 ECTS, BA, 180 ECTS. Në Kolegjin Biznesi dega në Gjakovë janë pezulluar këto programe: Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, dhe Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS. Në Kolegjin Biznesi dega në Vushtrri janë pezulluar këto programe të studimit: Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS; Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, dhe Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS. Në Kolegjin Biznesi dega në Prizren janë pezulluar këto programe: Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, dhe Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji Biznesi, është konstatuar që programet e cekura në pikën dy (2) dhe tre (3) të këtij vendimi, i plotëson kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Sipas kësaj pike, Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) duhet të ketë të paktën tre persona në marrëdhënie të rregullt pune të nivelit PhD për secilin program të studimit.

Për programet e tjera të pezulluara me vendim (nr.580/17, datë 06.07.2017), KSHC ka konstatuar që këto programe nuk i përmbushin kushtet sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Biznesi;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

